

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	'Uau', Trump festoi fitoren e AfD-së në Gjermani, kancelari Merz anulon telefonatën me presidentin amerikan
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/uau-trump-feston-fitoren-e-afd-se-ne-gjermani-kancelari-merz-anulon-telefon-i585012
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 16:01:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	9 shtator 2026, 16:40:06 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7b3bd81c74c08e2ddf0bb20ce4e3c691c318726ab830c9b8b5cef75bcfdca6d2
TEKSTI	3988525711a65fb04a40c9cd77a7f582831e3a57d13a5f1df4b1ee3aff27436d
PAMJA	537875d23223887798c61aa3c2fe60ed951476d3c84a508b6f11015a9854d70d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2de3842ebc2ac94e48cc816fa718b7d8868abace2ec8d183b2fb5ecdfca98667
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2de3842ebc2ac94e48cc816fa718b7d8868abace2ec8d183b2fb5ecdfca98667>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

[English](#)

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

[English](#)

1 e [Jahti luksoz me 1/3 pasagjere nga vende te ndryshme te botes mberrin ne portin e Sarandes Sivasspor ne kembet e Manajt, pa golat e shqiptarit skuadra e tij do te luante per mbijetesë](#) [APSK: Te ar fundit](#)

'Uau', Trump festoi fitoren e AfD-së në Gjermani, kancelari Merz anulon telefonatën me presidentin amerikan

9 Shtator 2026, 18:40Bota TEMA



 'Uau', Trump festoi fitoren e AfD-së në Gjermani, kancelari

Në Berlin nuk japin shpjegime. Thonë vetëm se nuk bëhet fjalë për një problem të axhendës. Telefonata mes kancelarit gjerman Friedrich Merz dhe presidentit amerikan Donald Trump, e planifikuar për sot, u shty me kërkesë të palës gjermane.

Koha kur ndodhi kjo nuk kaloi pa u vënë re. Vetëm një ditë më parë, Trump kishte përshëndetur fitoren e AfD-së në landin e Saksoni-Anhaltit, partia që sapo i shkaktoi CDU-së së Merzit humbjen më të rëndë në një zgjedhje rajonale.

Në rrjetin e tij social Truth Social, Trump shkroi:

"Uau! Partia populiste në Gjermani sapo pati një natë vërtet të madhe. Më në fund, gjermanët janë lodhur nga rregullat dhe politikat absolutisht të tmerrshme të emigracionit, që i kanë shkaktuar kaq shumë dëm Gjermanisë. JANË NË RRITJE dhe nuk kanë më ndërmend ta pranojnë këtë!"

Në fund të mesazhit ai shtoi edhe sloganin "Make Germany Great Again", një variant i sloganit të tij të njohur elektorale.

Kontrasti mes dy liderëve nuk mund të ishte më i madh. Trump e sheh rritjen e AfD-së si provë se gjermanët kërkojnë një ndryshim të kursit për emigracionin, ndërsa Merz e konsideron partinë e ekstremist të djathtë një kundërshtar që duhet ndaluar.

Kancelari e tha këtë me tone veçanërisht të ashpra gjatë debatit të përgjithshëm në Bundestag për projektbuxhetin, debat që u shndërrua në një përballje të drejtpërdrejtë me lideren e AfD-së, Alice Weidel.

Sipas Merzit, politika e "remigrimit" e mbështetur nga AfD-ja do të përbënte një formë "spastrimi etnik".

Weidel, nga ana tjetër, nuk kurseu sulmet ndaj kancelarit. Sipas saj, rezultati i zgjedhjeve në Saksoni-Anhalt tregon fundin e CDU-së.

AFD mori 43,8% të votave, ndërsa partia e Merzit ra në 17,2%. Një goditje e rëndë për kancelarin, i cili vetëm të hënën e kishte cilësuar rezultatin si "humbjen më të rëndë të CDU-së prej vitesh, në mos dekadash".

Zëdhënësi i qeverisë gjermane, Stefan Kornelius, nuk konfirmoi se shtyrja e telefonatës ishte pasojë e deklaratave të Trumpit.

Telefonata pritej të shërbente edhe për përgatitjen e aktiviteteve përkujtimore të 11 shtatorit 2001. Por ajo u shty pikërisht në një moment kur distanca mes Uashingtonit dhe Berlinit nuk duket më vetëm diplomatike: ajo përfshin emigracionin, Rusinë, Ukrainën dhe, në një nivel më të thellë, vetë idenë për Europën dhe demokracinë.

Duhet thënë se marrëdhënia mes Merzit dhe Trumpit nuk ka qenë kurrë e thjeshtë.

Gjatë vizitës në Shtëpinë e Bardhë, në qershor 2025, Merz ishte përpjekur ta bindte Trumpin të mbante një qëndrim më të ashpër ndaj Vladimir Putinit për luftën në Ukrainë, ndërsa presidenti amerikan e kishte krahasuar luftën me një sherr mes fëmijësh.

Më pas pati përpjekje për të zbutur marrëdhëniet. Vetëm tre muaj më parë, gjatë samitit të G7 në Evian, kancelari gjerman i dhuroi Trumpit një fanellë të kombëtares gjermane me emrin "Trump" dhe numrin 47, me rastin e 80-vjetorit të lindjes, duke i thënë: "Në fund të fundit, jemi në të njëjtën skuadër."

Sot, Trump feston fitoren e AfD-së, ndërsa Merz e konsideron atë një kërcënim.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Republikanët vendosin myslimanët në qendër të fushatës për zgjedhjet e mesmandatit në SHBA](#)

17:20 Bota / 3 komente

[Greva paralizon Holandën: Transporti publik pezullohet për shkak të shkurtimeve të përfitimeve sociale](#)

16:40 Bota / 1 koment

[Një tjetër pengesë në integrimin e Ukrainës drejt BE, Hungaria vendos një tjetër veto](#)

16:30 Bota / 3 komente

[Nga “magnet votash” në rrezik elektoral, Trump sfidon sondazhet dhe kundërshtarët](#)

16:10 Bota / 3 komente

[LNG, në “grackën” e Hormuzit - Katari dhe Emiratet kërkojnë rrugë alternative. Eksportet bien, kostot e transportit rriten](#)

15:50 Bota

[Zemërim pas raportit të 7 tetorit, Netanyahu përgjigjet me padi ndaj gazetës izraelite](#)

15:40 Bota / 1 koment

[Merz: AFD mbështet politika sinonim të spastrimit etnik](#)

14:30 Bota / 4 komente

[Britani, rinisin fluturimet: Disa aeroporte ishin bllokuar pas defektit në kontrollin e trafikut](#)

14:10 Bota

[Përshkallëzimi i luftës në Lindjen e Mesme rrit çmimin global të naftës](#)

[Liderja e AfD: Gjermania duhet të kufizojë pagesat ndaj BE-së, ne duam paratë tona mbrapsht](#)

13:40 Bota / 28 komente

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[Berisha vijon turin në SHBA, mbështetësi nga Teksasi: U b...](#)

14:15 Politika / 54 komente

[FOTO: Marjana Koçeku iu bashkohet deputetëve të Sali Beri...](#)

17:35 Politika / 130 komente

[Nga Banka e Shqipërisë tek Parlamenti Evropian, punësimet...](#)

14:50 Politika / 10 komente

[Do blinte toka në Shqipëri, do investonte në Bogovë dhe u...](#)

22:50 Kronika / 6 komente

[Incidenti me disa protestuese, reagon Iris Luarasi: Do e ...](#)

19:40 Politika / 125 komente

Blog Tema

[Sa të interesuar janë adoleshentët shqiptarë për politikën?](#)

17:30 Blog

[Republika popullore e protestës](#)

15:20 Blog / 42 komente

[Pandeli Majko: Liria nuk gjykohet...](#)

13:00 Blog / 14 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

REGJISTROHU

Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetatat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- [Politika](#)
- [Kronika](#)
- [Editorial](#)
- [Blog](#)
- [Bota](#)
- [Sport](#)
- [Shëndeti](#)
- [Turizëm](#)

- [Sociale](#)
- [Ekonomia](#)
- [Antena](#)
- [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Lifestyle](#)
- [Dossier](#)
- [Hi-Tech](#)

- [Kontakt](#)
- [Ta dhënat personale](#)

- [Cookies](#)

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.